

Mjetet financiare per studime perbehen nga dy pjesë: njëra është ndihmë ndërsa tjetra është kredi studentore. Ndihma studentore përbënë nje te treten e mjeteve financiare dhe nuk ka nevojë të kthehet. Kredia janë të holla që duhen të kthehen më vonë. Tek gjashtë muaj pas perfundimit te studimeve njeriu fillon te paguaj kthimin e kredisë studentore. Shuma e të paguarit bazohet në sasinë e të hollave të huazuara, lartësia e kamatës, sa vite njeriu mund të paguaj dhe sa i ka të ardhurat

Per informacione rreth mjeteve financiare per student, kontaktojeni CSN-in në numrin e telefonit 060-18 60 00 apo shiko në Internet www.csn.se.

KU DO TË BANOJ ?

Është e rëndësishme që njeriu të mësojë në shtëpi kur nuk ka ligjërata në universitet. Ai që banon afër universitetit, natyrisht që mund të vazhdoj të banoj në shtëpi. Ai që duhet apo don të shpërngulet ka disa forma banimi për të zgjedhur. Një mënyrë e mire për t'u inkuadruar në jetën studenteske është banimi "në korridor" ku kuzhina dhe vendi i bukës është i përbashkët me student të tjerë. Por ka edhe banesa për student dhe alternativa private. Një pjesë e studentëve banojnë jashtë Lundit si për shembull në Malmö dhe Eslöv. Aty mund të jetë më lehtë për të gjetur banesë. Distancat për udhëtim janë të shkurtra dhe lidhjet e komunacionit janë të mira.

Shoqata e akademikëve (ShA) si dhe unionet e ndryshme të studentëve, ndërmjetsojnë ndarjen e dhomave në konvikte si dhe të banesave të madhësive të ndryshme. Mund të jetë mjaftë e vështirë të gjendet dhoma për student. Andaj është shumë e rëndësishme që të paraqitni interesin tuaj për dhoma studentësh si të pranoheni në

universitet. ShA-banesa numrin e telefonit eka 046-19 15 00 mund të kontaktohet edhe nëpërmes adresës së webit: www.lu.se/boende. Banesat e unioneve të studentëve mund të kërkohen nëpërmes të njëjtës adresë në Internet.

Bopoolen është një ndërmarrje për ndërmjetsimin e banesave e cila pranon fletajmerimet për banesa qysh para se të dihet se nëse studenti është pranuar në universitet apo jo. Ata kanë numër telefoni 046-222 04 40 ose 046-222 17 75 dhe adresa në Internet është: www.lus.lu.se/bopoolen/

Zyra qendrore konsulti për zgjedhjen e profesionit 046-222 01 00, orari telefonik prej ores 10–12.

Porositja e katalogut 046-222 70 54 apo www.lu.se/katalogbestallning

Informacione rreth provimit pranues jepen nëpërmes zyrës qendrore konsulti për zgjedhjen e profesionit apo nëpërmes internetit në adresën e en tit të shkollave të larta: www.studera.nu

Data e paraqitjes

Data e fundit e paraqitjes për semestrin pranveror 15 tetori

Data e fundit e paraqitjes për semestrin vjeshtor 15 prill



LUND UNIVERSITY

Print: Holmbergs, Malmö, 1 000 copies, December 2007 • Photo: Mikael Risedal • Translation: Semantix



TË STUDIOSSH PRAN UNIVERSITETIT TË LUNDIT

Në Suedi afërsisht gjysma e popullatës, ndonjë herë studion në shkollë të lartë apo fakultet. Afërsisht gjysma meshkuj e gjysma femra. Arsimimi i lartë e bënë më të lehtë punësimin dhe i'a hapë shumë dyerë së ardhmës. Andaj studimet universitare mund të jenë një investim i mirë dhe në shumë raste mund të përdoret edhe në vende tjera. Gjithnjë e më shumë punëdhënës kërkojnë që personeli të njohë kultura dhe gjuhë tjera. Përveq kësaj tregu i punës po bëhet gjithnjë e më shumë internacional.

UNIVERSITETI I LUNDIR

Universiteti i Lundit është më i madhi në Suedi me 39 000 student. Këtu janë arsimuar student gati qe 350 vjetë. Universiteti ka drejtime në të gjitha fushat shkencore. Si student mund të studiosh drejtime profesionale ose lëndë të pavarura në kuadër të teknikës, shkencave natyrore atyre flozofike, mjekesise, juridikes, shkencave shoqërore dhe teologji. Shkolat e larta të muzikës, artit dhe teatrit të universitetit gjenden në Malmö. Në Ljungbyhed arsimohen pilotët në kuadër të aviacionit ndërsa në Helsingborg, universiteti i Lundit arsimon inxhi-nier, biolog marine, komunikatorë, socionomë dhe ekonomista për sektorin e hotelerisë.

Universiteti i Lundit është universiteti më internacional i Suedisë. Këtu ka student, skenctarë dhe profesorë nga kultura dhe vende të të ndryshme. Ky universitet bashkpunonë me qindra universitete në tërë botën. Shumë student të huaj studiojnë në Lund dhe shumë studentë të Lundit zgjedhin që disa vite nga studimet e tyre t'i bëjnë në shtete tjera.

Gjithnjë e më shumë të rinjë suedeze me origjinë nga vendet e tjera zgjedhin që të studiojnë në universitetin e Lundit. Meqenëse shumëllojshmëria e nacionaliteve dhe kulturave konsiderohet si diçka pozitive për universitetin e Lundit, atëherë punohet aktivisht që të rekrutohen studentë me origjinë imigrantësh.

SI TË PRANOHEM NË UNIVERSITET

Njeriu duhet të ketë parnjohuri për t'u pranuar në universitet. Ekzistojnë dy nivele të parnjohurive: kompetenca themelore dhe kompetenca e posaqme. Për të gjitha drejtimet në universitet kërkohet kompe-

tenca themelore. Kjo kompetencë merret në të gjitha drejtimet e shkollës së mesme. Shumica e drejtimeve kërkojnë poashtu edhe kompetencë të posaqme. Kjo do të thotë se studenti duhet të ketë disa njohuri ekstra në disa lëndë. Nganjëherë numri i aplikuesve (kërkuesve) është i madhë dhe të gjithë nuk mund të pranohen. Atëherë duhet bërë zgjedhjen në mesin e aplikantëve. Aplikuesit ndahen në grupe të ndryshme (grupe përzgjedhëse) dhe shikohen notat e tyre dhe/ose rezultati nga provimi pranues. Për më shumë informacion, shih katalogun actual të paraqitjes.

Shkolla e mesme nga vendet e tjera që jepë kompetencë për të studijuar në shkollë të lartë në ato vende vlenë edhe në Suedi. Por studentit duhet të dëshmojë se ka njohuri në suedishte dhe anglishte.

Nëse notat nga shkolla e mesme nuk mjaftojnë për t'u pranuar në atë drejtim që dëshiron atëherë ka disa mundësi të caktuara që notat të përmirësohen. Kjo mund të bëhet duke mësuar në shkollën komunale për të rritur (komvux), apo në shkollë të lartë popullore ose duke e bërë provimin pranues për shkolla të larta. Provimi pranues për shkolla të larta organizohet dy herë në vitë dhe ai që tregon rezultate të mira i rritë gjasat për t'u pranuar në studime të caktuara. Por kushtet rreth kompetencës themelore dhe kompetencës së posaqme duhet në të gjitha rastet të përmbushen. Provimi pranues mund të jepet sa here të duash.

Informata më të shumta rreth provimit pranues mund të merrni në www.lu.se/ hogskoleprovet apo në zyrën qendrore për konsultim rreth zgjedhjes së profesionit në numrin e telefonit 046-222 01 00. Prej orës 10–12.

ÇKA TË ZGJEDHË?

Në universitetin e Lundit mund të zgjedhni në mesin e 140 drejtimeve profesionale dhe mbi 1000 kurseve. Nëse njeriu zgjedhë drejtim profesional, atëherë universiteti vendos paraprakisht se cilat lëndë hyjnë në atë drejtim ku njëkohësisht keni edhe vendet e siguruar në këto lëndë. Nëse zgjedhni kurse të pavarura atëherë duhet të kërkoni vetë vendet e lira për çdo gjysmëvjetor. Kjo kërkon përgjegjësi më të madhe por jep edhe liri më të madhe.

POENA DHE DIPLOMA

Kurset japin poena. Një javë e studimeve me orarë të plotë japin 1,5 pikë të shkollës së lartë. Një gjysmëvjetor i studimeve të rregullta japin 30 pikë të shkollës së lartë. Ai që studion dy vite merrë 120 pikë të shkollës së lartë, dhe diplomën më të ulët të universitetit, një të ashtuquajtur diplomë e shkollës së lartë. Diploma kandidati (fil. kand.), apo tri vite studimesh japin 180 pikë të shkollës së lartë dhe diploma e magjistris (fil. mag.) apo katër vite studime japin 240 pikë të shkollës së lartë.

INFORMACION MBI ARSIMIMIN

Në revistën e arsimimit ka informacione rreth drejtimeve arsimore në kuadër të universitetit. Ka po ashtu edhe një katalog i posaqëm i paraqitjes për kurse. Revista e arsimimit dhe katalogu i paraqitjes mund të porositen në numrin e telefonit 046-222 70 54. Ata që kanë nevojë për ndihmë mund t'i drjtohen këshilltarëve për zgjedhjen e profesionit në universitet në të njëjtin numër të telefonit. Mund të flisni edhe me këshilltarët për zgjedhjen e profesionit të cilët gjenden në shumicën e shkollave. Në adresën e universitetit www.lu.se/valjastudier gjenden si katalogjet ashtu edhe informacione të tjera rreth studimeve.

Për atë që punon apo për ndonjë arsye tjetër nuk mund të vijoj studimet e rregullta ka mundësi që shumë drejtime arsimore të studijohen përmes internetit. Njëpërmes kompjuterit mbani kontakt të shpeshtë me profesorët dhe shokët e tjerë student. Disa kurse janë të bazuara tërësisht në internet ndërsa të tjerat përmbajnë edhe disa takime në universitet.

SHËRBIMI I GJUHËS

Që një kohë pran universitetit të Lundit ekziston një uzinë studimi me shërbim gjuhësor së cilës uzinë mund t'i drejtohen të gjithë ata që kanë nevojë për ndihmë rreth të shkruarit akademik dhe për përmirësimin e teknikës së studimit. Këtu u ndihmohet studentëve edhe me gjuhën suedeze. Informata më të hollësishme rreth uzinës së studimeve ka në faqen e universitetit në adresën. www.lu.se/studieverkstad

SA KUSHTON?

Të studiosh në universitet nuk kushton asgjë. Por natyrisht njeriu ka nevojë për të holla për ushqim, banim, libra dhe material tjetër. Menyra me e zakonshme për t'i financuar studimet është që të kërkohen mjete financiare për studime nga CSN (instuticion për ndarjen e mjeteve financiare për student). Në Suedi përfaqësohet 80 përqind e të gjithë studenteve marrin mjete financiare studentore. Nuk është e rendomt që studimet të financohen nëpërmes bursave. Ato burse që ekzistojnë janë të vogla dhe shërbejnë vetëm si shtesë në arkën e ekonomisë.

Të gjithë studentët të cilët kanë jetuar në Suedi së paku dy vite kanë të drejtë të kërkojnë mjete financiare për studime. Nuk ka rëndësi nëse njeriu ka të holla në bankë apo se sa i ka të ardhurat familja.